

#INNO4EDU

Titulli i aktivitetit

Mbrojtje nga zjarri

Mosha

Periudha zhvillimore (nga mosha 8 deri në 10 vjeçe)

Hapësira / lokacioni

Kushte shtëpie

Vlera e karakterit

Përqendrim

Koha e nevojshme për përgatitje

10 minuta

Koha e nevojshme për realizim

30 minuta

Qëllimet

Qëllimi është që fëmija të njihet me rregullat për sjellje të sigurtë në shtëpi dhe të sillet në mënyrë të përgjegjshme ndaj punëve të veta dhe atyre që janë të përbashkëta.

Rezultatet e pritshme

Fëmija i di rregullat për sjellje të sigurtë dhe sillet në mënyrë të përgjegjshme si ndaj punëve të veta ashtu edhe ndaj atyre që janë të përbashkëta.

Kahje

Përgatitje paraprake për aktivitet

Bisedë me fëmijën për atë se në botë çdo vit zjarret shkaktojnë dëme të mëdha materiale dhe humbje të jetëve njerëzore. Prandaj është me shumë rëndësi të aftësohen se si të parandalohen dhe si të mbrohemi nga zjarret me përgatitjen e një programi të përbashkët për preventivë nga zjarret.

Shikimi i një filmi të animuar (shtesa nr. 1) dhe bashkëbisedim.

Përgatitje e materialeve për shkrim (laps dhe fletë letre për vizatim të hartës së dhomave në shtëpi).



Instrukcione/kahje për lojën

Aktiviteti zhvillohet në 5 pjesë, të cilat prindi duhet t'i udhëheqë sipas udhëzimeve të dhëna më poshtë.

Aktivitet/lojë

1 – FAKTE PËR ZJARRIN

Ky aktivitet duhet t'i përfshijë informacionet e përgjithshme në raport me flakën dhe zjarret, gjegjësisht përmes bisedës me fëmijën duhet të zbulohet sa njohuri ka dhe t'i jepen informata plotësuese në lidhje me temën.

Flaka e kontrolluar llogaritet se është një nga miqtë më të mirë të njeriut.

Njerëzit primitivë e kanë shfrytëzuar për:

- ngrohje;
- gatim;
- shndërim të argjilit në qeramikë;
- ndriçim.

Përveç se siguron dritë, njerëzit sot zjarrin e shfrytëzojnë për të njëjtat punë. Ai, po ashtu, e furnizon energjinë për punën e motorëve me avull si dhe makinave të tjera. Përdoret për ndarjen e metaleve nga xehet e tyre dhe për shumë procese kimike.

Zjarri i pakontrolluar është një nga armiqtë më të këqij të njerëzimit. Zjarret shkaktojnë shumë raste vdekjesh dhe me miliarda denarë dëme të pronave në disa shtete. Disa zjarre janë shkaktuar nga shkaqe natyrore, për shembull rufetë shpesh shkaktojnë zjarre në male. Disa zjarre janë shkaktuar nga pakujdesia, ndërsa të tjera qëllimisht janë shkaktuar nga njeriu.

2 – SHËTITJE PËR SIGURI

Shëtitni nëpër shtëpinë tuaj dhe vërreni pozicionet e vendeve me potencial rrezikshmërie ose të aparateve, të cilat mund të shkaktojnë zjarre dhe i shënoni në hartën paraprakisht të vizatuar.

3 – PLANI I SIGURISË

Pastaj fëmija ka për detyrë t'i shënojë dyert dhe dritaret e shtëpisë. Nëse jetojnë në banesë apo shtëpi me disa kate, të shënohen shkallët dhe ndërtesat / shtëpitë shoqëruese. Me fëmijët të bisedohet për rolin e aparateve kundër zjarrit, hidrantëve e të ngjashme, e pastaj të bëhet një plan dhe shteg për lëvizje në rast zjarri në shtëpi ose në rrethinën e saj.

4 – POSTERË PËR SIGURI

Anëtarët e familjes duhet bashkërisht të krijojnë posterë për siguri dhe parandalim të zjarreve. Mund të shpikin edhe një slogan të mirë dhe të përdorin ngjyra të hapura e të

thjeshta dhe shkronja të mëdha dhe posterit të vendoset në një vend të dukshëm në shtëpi.

5 – SHËRBIMI KUNDËR ZJARREVE 193

Me fëmijën bisedohet për rolin e shërbimit për Mrojtjen kundër zjarreve, automjetet e specializuara, pajisja e tyre dhe roli i zjarrfikësve.

Është me rëndësi që çdo fëmijë ta dijë numrin e telefonit ku mund ta thërrasë Brigadën e zjarrfikësve.

Shtesa

Materiale

Shtesa nr. 1

Link i videos nga punimi



Materiale për shkrim (laps dhe fletë letre) dhe materiale për art figurativ

Aktiviteti është përgatitur nga:

Edukatore: Sonja Çallovaska, Vesna Peceva

Dizajn grafik: Katerina Nikolovska

Lekturë: Jana Mihajlovaska

Dërkthim: Agim Leka

